REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4236/1 Prot

Rrëshen, më 01 . 10 . 2026

V E N D I M

Nr. 80 datë 25. 09. 2026
PËR
"NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2026, DHE PLANIFIKIM NË PBA 2027 - 2029, PËR BASHKËFINANCIM OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I PLOTË I SHKOLLËS DHE NDËRTIMI I TERRENEVE SPORTIVE, TË SHKOLLËS 9-VEÇARE RUBIK", BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", neni 15, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", Udhëzimi nr. 9, datë 27.04.2022, "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionin e nevojshëm, për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për financim/bashkëfinancim e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive", Urdhërin e Ministrit të Arsimit nr. 199, datë 01.06.2026, në shkresën e Ministrisë së Arsimit, Drejtorisë Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me nr. 4235 prot, datë 20.07.2026, me objekt: "Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë Arsimit", Kërkesën e DPZHT Bashkia Mirditë, nr. 3984 prot, datë 03.09.2026, *"Kërkesë për transferim buxheti në Bashkinë Mirditë"* së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 23.09.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit,* për t'ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshim buxheti, si më poshtë;

A. Paksim fondi:

A.1 Objekti; "Rikonstruksion palestre, shkolla e mesme Rubik":

- AD133.....2133001.....01.....231.....V923AAB.....**1 348 314** lekë

A.2 Objekti; "Ndërtim zyra Njësia Administrative Kthellë":

- AB133.....2133001.....01.....231.....P452AAB.....**3 087 991** lekë

A.3 Objekti; "Ndërtim kënd lojrash":

- AD133.....2133001.....01.....231.....V912AAA.....**1 000 000** lekë
- AA133.....2133001.....01.....606.....V111AAA.....**444 425** lekë

TOTAL PAKSIM;.....**5 880 730** lekë

B. Shtesë fond:

B.1 Objekti; "Bashkëfinancim, rikonstruksion i plotë i shkollës dhe ndërtim i terreneve sportive të shkollës 9-vejçare" Rubik

- AD133.....2133001.....01.....231.....kod i pa përcaktuar.....**5 880 730** lekë

2. Planifikimet për vitet **2027-2028** duke qënë investim me financim **3 (tre)** vite buxhetimi në **PBA 2027-2029** bashkëfinancim

3. **Viti 2027**
   AD133.....2133001.....01.....231.....kod i pa përcaktuar.....**5 894 117** lekë

4. **Viti 2028**
   AD133.....2133001.....01.....231.....kod i pa përcaktuar.....**17 628 804** lekë

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë; (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

KRYETAR

Aleksandër PICAKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr4236prot Rreshen me 18/09/2026

P/V E N D I M

Nr. 93 date 18.09.2026

"PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2026, DHE PLANIFIKIM NE PBA 2027-2029, PER BASHKEFINANCIM OBJEKTI: "RIKONSTRUKSION I PLOTE I SHKOLLES DHE NDERTIM I TERRENEVE SPORTIVE TE SHKOLLES 9-VJEÇARE RUBIK"

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" neni 15, "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", udhezimin nr.9, date.27.04.2022 "Per kriteret procedurat dhe afatet per shpalljen e thirrjes dhe per dokumentacionin e nevojshem, per aplikim nga njesite eveteqeverisjes vendore per financim/bashkefinancim e projekteve per permiresimin einfrastruktures shkollore dhe sportive" ne urdherin e ministrit te arsimit nr.199, date 01.06.2026, ne shkresen e Ministrise se Arsimit , Drejtorise se Buxhetit dhe menazhimit Financiare, nr.4235 prot, date..20.07.2026 me objket "Njoftim per shpalljen fitues te projekteve te aplikuara prane MA", kerkesen e DPZHT bashkia Mirdite, nr.3984, dt.03.09.2026 "Kerkese per transferim buxheti ne bashkine Mirdite", Këshilli i Bashkisë Mirditë, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

V E N D O S I:

I-Ndryshim buxheti si me poshte:

A-Paksim fondi:
A/1-Objketi "Rikonstruksion palestre, shkolla e mesme Rubik"
-AD133....2133001.....01.....231.....V923AAB.....1 348 314 leke
A/2-Objketi "Ndertim zyra e NJA Kthelle"
-AB133....2133001.....01.....231.....P452AAB.....3 087 991 leke
A/3-Objketi "Ndertim kend lojrash"

-AD133....2133001.....01.....231.....V912AAA.....1 000 000 leke
-AA133....2133001.....01.....606.....V111AAA.....444 425 leke

TOTAL PAKSIMI.....5 880 730 LEKE

B-Shtese fond:
B/1-Objketi "Bashkefinancim , rikonstruksion i plote i shkolles dhe ndertim i terreneve sportive te shkolles 9-vjeçare"
AD133.....2133001.....01.....231.....(kod i pa percaktuar).....5 880 730 leke

***II*-Planifikimet per vitet 2027-2028(duke qene investim me financim tre vite buxhetimi) ne PBA 27-29(bashkefinancimi):**
A/II-Viti 2027
AD133.....2133001.....01.....231.....(kod i pa percaktuar).....5 894 117 leke
B/II-Viti 2028
AD133.....2133001.....01.....231.....(kod i pa percaktuar).....17 628 804 leke

***III*-**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise

VI*-Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksandër PICAKU

Paraqiten projekti

Dr. FINANCE/BUXHET:V.Gjoka
Dr.AAS A.Çupi
Përgj.sekt juridik: L.Gjergji

KRYETARI

Albert MËLYSHI

ME DELEGIM KOMPETENCASH
Gjergj PRENGA

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

Tabela e perrllog 15% te bashkefinancimit shkolla e mesme Rubik

ne leke

Vitet buxhetore	Financimi MA	%	bashk.fin bashkia	%	**Total vlere projekti**
2026	33324138	85	5880730.235	15	**39204868.24**
2027	33400000	85	5894117.647	15	**39294117.65**
2028	99896553	85	17628803.47	15	**117525356.5**
SHUMA	166620691		29403651.35		**196024342.4**

Te dhenat sipas urdherit te zv MA nr.382, date.20.07.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3984 **Prot.** **Rrëshen, më** 03 . 09 **.2026**

Drejtuar:Drejtorisë Financës dhe Buxhetit

Nga :Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Lënda:Kërkesë për transferim buxheti, në bashkinë Mirditë

Në kuadër të realizimit të investimeve të parashikuara për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës arsimore, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, pas shqyrtimit të nevojave dhe ecurisë së procedurave për Rikonstruksionin i plotë i shkollës dhe ndërtimi i terreneve sportive të shkollës 9 vjecare Rubik, konstaton nevojën për **plotësimin e fondit të parashikuar për realizimin e këtij investimi**.

Rikonstruksion i plotë i shkollës dhe ndërtimi i terreneve sportive të shkollës 9 vjecare Rubik përbën një investim me rëndësi të veçantë për komunitetin, duke synuar krijimin e ambienteve bashkëkohore, të sigurta dhe funksionale për zhvillimin e procesit mësimor, si dhe përmirësimin e kushteve për nxënësit dhe stafin pedagogjik.
Nga verifikimi i dokumentacionit teknik, preventivave dhe vlerësimeve të kostove të nevojshme për realizimin e punimeve, rezulton se fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit kërkon 15% të vlerës se ndërtimit financim nga bashkia Mirditë, duke qenëse në buxheti i bashkisë për vitin 2026 nuk ka qënë i parashikuar si projekt për përfundimin dhe realizimin me cilësi të plotë të investimit të parashikuar kërkon transferimin e fondeve të tjera.

Për sa më sipër, kërkojmë nga **Drejtoria e Financës dhe Buxhetit** të shqyrtojë mundësinë e sigurimit dhe plotësimit të fondit financiar të nevojshëm për **Rikonstruksionin i plotë i shkollës dhe ndërtimi i terreneve sportive të shkollës 9 vjecare Rubik,** në përputhje me vlerën e përcaktuar në preventivat dhe dokumentacionin teknik përkatës.
Nisur nga planifikimi dhe analizat financiare të projekteve përkatëse:

1. **Paksim fondi për " Rikonstruksion Palestra Shkolla e Mesme Rubik" I cili është transferim I pakushtezuar grand përformancë në shumën 1'348'314 Lekë.**

2. **Ndryshim VKB nr 39 datë 26. 05. 2026 Për "Miratimin, Përdorim Fond Mbrojtjes Civile dhe Ndryshim në Buxhetin e Vitit 2026 Bashkia Mirditë pika 2c ku fondi i**

planifikuar për ndërtimin e Njësisë Administrative Kthellë me shumën 3'087'991 Lekë.

3. **Paksim fondi për "Ndërtim Kënd Lojrash" I cili është në shumën 1'000'000 Lekë.**

Shuma në total e të tre zërave do të përdoren për objektin "Rikonstruksionin i plotë i shkollës dhe ndërtimi i terreneve sportive të shkollës 9 vjecare Rubik.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të procedimit të mëtejshëm zyrtar dhe pasqyrimit të këtyre ndryshimeve në sistemin financiar.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Ark. Juljan TUSHA

KRYETARI
Albert MËLYSHI

ME DELEGIM KOPETENCASH
ME VENDIM
ZV. KRYETAR
Gjergj PRENGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr.4235/1 Prot.

Tiranë, më 20.07.2026

Lënda: Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit

BASHKISË Mirditë

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, urdhrit nr. 382, datë 20.07.2026, të Zëvendësministrit të Arsimit "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2026-2028, nga programet "Arsimi Bazë" dhe "Arsimi i Mesëm" për infrastrukturën shkollore", ju bëjmë me dije se jeni shpallur fitues për projektin/ projektet sipas tabelës bashkëlidhur.
Konform legjislacionit të sipërcituar si dhe bazuar në:

1. Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, të ndryshuar, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
2. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.
3. Vendimin nr. 354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje, kolaudim".
4. Vendimin nr. 319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", të ndryshuar.
5. Vendimin nr. 216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
6. Vendimin nr. 537, datë 08.07.2020, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave".
7. Vendimin nr. 26, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".
8. Vendimin nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".
9. Vendimin nr. 9, datë 11.1.2024 "Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t'i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste"

Pas miratimit të çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bashkia duhet të fillojë procedurat për realizimin dhe përmbushjen në afat të detyrimeve.
Pas realizimit të procedurave të prokurimit një kopje e kontratës së nënshkruar duhet të përcillet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

Nr.4235 Prot.

Datë 29.07.2026

URDHËR

Nr.382, datë 29.07.2026

PËR

SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, ME CIKËL FINANCIMI 2026-2028, NGA PROGRAMET "ARSIMI BAZË" DHE "ARSIMI I MESËM" PËR INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 15, pika 11, të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimit nr. 9, datë 27.04.2022 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e të infrastrukturës shkollore dhe sportive", urdhrit nr.497, datë 29.09.2025 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit, Znj. Orjana Osmani":

URDHËROJ :

1. Miratimin e projekteve të reja, me cikël financimi 2026-2028, thirrja e parë, të cilat financohen nga programet buxhetore "Arsimi bazë" dhe "Arsimi i mesëm".
2. Masa e financimit nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin, për periudhën afatmesme 2026-2028, si dhe pjesa takuese e bashkëfinancimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, është sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, projektet e të cilëve janë shpallur fituese, njoftohen zyrtarisht për marrjen e masave për realizimin e procedurave të prokurimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

stria e Arsimit
e projekteve Fituese per periudhe 2026-2028

Qarku	Bashkia	Kodi	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë (Lekë)	Fondet nga MAS (Lekë)	Kontribut NJQV (Lekë)	Viti 2026 (Lekë)	Viti 2027 (Lekë)	Viti 2028 (Lekë
Lezhë	Mirditë	9120	Rikonstruksion I plote I shkollës dhe ndertimi I terreneve sportive te shkollës 9 vjeçare Rubik	196,024,342	166,620,691	29,403,651	33,324,138	33,400,000	99,896,553

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
MINISTRI

Nr.....prot.4235/1 Datë.01/06..2026

URDHËR

Nr. 199, datë 01/06 2026

PËR

SHPALLJEN E THIRRJES SË PARË PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NGA PROGRAMET "ARSIMI BAZË" DHE "ARSIMI I MESËM", PJESË E PROGRAMIT PËR INFRASTRUKTURËN SHKOLLORE PËR PROJEKTET ME CIKËL FINANCIMI 2026-2027.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.87 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026si dhe Udhëzimit. Nr.9 datë 27/04/2022 "Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionin e nevojshëm për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirësimin e të infrastrukturës shkollore dhe sportive",

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve të reja, me cikël financimi 2026-2027, nga fondi i miratuar për vitin 2026 për infrastrukturën shkollore, në programet buxhetore "Arsimi bazë" dhe "Arsimi i mesëm".

2. Drejtimet e thirrjes për financim:

   1) Ndërtimi, rehabilitimi dhe/ose zgjerimi i kapaciteteve të institucioneve/objekteve arsimore ekzistuese në arsimin bazë (kopshte/shkolla), që kanë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturën fizike, me qëllim reduktimin/eliminimin e mësimit me turne, përqëndrimin e klasave kolektive, aty ku është e mundur dhe përmirësimin e kushteve të mjediseve arsimore për nxënësit/fëmijët që mësojnë në shkollat 9-vjeçare;

   2) Ndërtimi, rehabilitim dhe/ose zgjerimi i kapaciteteve të objekteve arsimore ekzistuese në arsimin e mesëm, të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje dhe/ose kanë të domosdoshme ndërhyrjet në infrastrukturën fizike;

3. Vlera e bashkëfinancimit nga aplikanti për çdo projekt, është sipas shtojcës I, bashkëlidhur.

4. Cikli i financimit te projekteve është 2 (dy) vite buxhetore, përkatësisht viti 2026 dhe 2027, në varësi edhe me ecurinë e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të projektit nga kontraktorët dhe NJVV-të. Diferenca ndërmjet vlerës së kontratës së nënshkruar (duke hequr pjesën takuese të bashkëfinancimit) dhe financimit që NJVV-të përfitojnë nga MA në vitin 2026, do të financohet në vitin pasardhës.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat paraqesin më shumë se një aplikim, duhet të rendisin ato sipas prioritetit për financim.

6. Data e shpalljes së thirrjes për aplikim është data e publikimit në web-in e Ministrisë së Arsimit dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik.

7. Aplikimi për financimin e projekteve bëhet nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) sipas shtojcave II e III , bashkëlidhur.

8. MA do të vlerësojë dhe financojë për projektet me cikël financimi 2026-2027, vetëm aplikimet e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) të cilat nuk kanë përfituar fonde në kuadër të procesit të rindërtimit.

9. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, për të gjithë projektet e shpallur fitues, MA do të njoftojë zyrtarisht NJVV-të.

10. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Komisioni për shqyrtimin e projekteve, drejtoria e buxhetit dhe menaxhimit financiar për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në web-in e Ministrisë së Arsimit dhe Agjencinë e Prokurimit Publik.

MIRELA KUMBARO FLUXHI

MINISTRE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- MINISTRIA E ARSIMIT

Shtojcë I: VLERA E BASHKËFINANCIMIT PËR APLIKUESIT

Vlera e bashkëfinancimit për çdo projekt nga NJVV-të, është sa më poshtë:

a) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana e NJVV të jetë në masën 15% të vlerës së plotë të projektit, alokuar për vitin korrent ose i përpjestuar për vitin pasues. (nëse projekti zbatohet në dy vite);

b) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të jetë në masën 20% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 10% për vitin korrent dhe 10% për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vite);

c) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) me popullsi mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë, vlera dysheme e bashkëfinancimit nga ana NJVV, të jetë në masën 25% të vlerës së plotë të projektit, nga të cilat alokuar 15% për vitin korrent dhe 10% për vitin pasues (nëse projekti zbatohet në dy vite)

Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës nëse ka një të tillë pas prokurimit publik do ti zbritet financimit me burim fondet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, pjesë e fondeve për financimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive.

SHËNIM:
Ministria e Arsimit, bazuar edhe në të dhënat e INSTAT, i kërkon Ministrisë së Brendshme listën (sipas të dhënave të vitit te fundit) të njësive të vetëqeverisjes vendore, me mbi dhe nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, për tu referuar pranë Komisionit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Shtojcë II: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në web-in e MA dhe/ose "Agjencinë e Prokurimit Publik"	Ministria e Arsimit	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes, sipas pikës 1 ,2 dhe 3 të këtij udhëzimi.
30 ditë kalendarike nga data e botimit në web e MA dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik	Aplikuesit sipas pikës 3, të këtij udhëzimi/NJQV	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në format hard-copy si dhe CD) dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit
15 ditë kalendarike nga afati i mbylljes së aplikimit	Komisioni i MA	Vlerësimi i projekteve të aplikuara sipas shtojcës III, të këtij vendimi.
	Komisioni i MA	Komisioni paraqet zyrtarisht pranë kryetarit listën e projekteve që propozohen për financim.

Shtojcë III: FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	NJVV respektive
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet nga NJVV
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë MA.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilën drejtim të thirrjes aplikohet (sipas drejtimit të thirrjes së shpallur nga MA).
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	Të jepet data kur parashikohet të përfundojë projekti
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit: specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen; - Standardi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar, në projektim; - Grafiku i prokurimit dhe grafiku i zbatimit të punimeve; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Për shkollat në fshatrat dhe/ose njësitë e qeverisjes vendore nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, aplikuesi paraqet informacion për numrin aktual dhe të pritshëm të nxënësve të shkollës, për të cilat kërkohet bashkëfinancimi, si dhe për shkollat dhe numrin e nxënësve në shkollat që gjenden në një distancë prej 4–5 km nga shkolla që kërkohet bashkëfinancimi, me qëllim optimizimin e mundësisë së investimit, përmes grupimit; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifikë të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.

Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyn projekti dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 (një) projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj; - Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.
Fondet e kërkuara nga MA(*)	Në rast se projekti nuk ka financim nga donatorë, kostoja/fondi që kërkohet është e barabartë me koston totale të projektit (në çdo rast, vlera të jetë me TVSH) minus vlerën dysheme të detyrueshme të bashkëfinancimit nga njësia e qeverisjes vendore, sipas shtojcës I të këtij udhëzimi.
Kontributi i detyrueshëm në bashkëfinancim nga njësia e qeverisjes vendore (*)	Aplikuesi e shoqëron aplikimin me një shkresë zyrtare, të nënshkruar nga kryetari i bashkisë, ku merr përsipër së paku vlerën dysheme të bashkëfinancimit për këtë aplikim, të përcaktuar në shtojcën I të këtij udhëzimi. Aplikuesi mund të bashkëfinancojë një vlerë me të madhe sesa vlera dysheme, nëse e shikon të mundur. Marrja përsipër e bashkëfinancimit nga aplikuesi, në, minimumi, vlerën dysheme të tij të përcaktuar në shtojcën I, të këtij udhëzimi dhe paraqitja e shkresës që e konfirmon këtë është kusht detyrues për kalimin në fazën e vlerësimit të aplikimit dhe për (potencialisht) miratimin e financimit.
Financim nga donatorë (*)	Nëse ka financim nga donatorë, të jepet vlera e pritshme e donacionit në monedhën lekë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi, të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	☐ Po / ☐ Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.

Deklarime (*)	Aplikuesi deklaron se: i. Projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimi i punimeve. ii. Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe/ose të prioriteteve. iii. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues ka siguruar/siguron pajisjen me të gjitha lejimet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iv. Janë zbatuar çmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përllogaritjen e kostos dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse dosja e aplikimit përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit; - preventivin; - grafikun e prokurimit dhe grafikun e zbatimit të punimeve; - relacionin teknik; - specifikimet teknike; - CD; - përllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshem	Imazhe në formatin jpeg ose .pdf

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

Shënim: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit në format hard copy dhe CD, pranë Ministrisë së Arsimit.

2. Formati i aplikimit duhet të dorëzohet i firmosur dhe i vulosur nga institucioni/subjekti aplikues.

3. Dokumentacioni teknik i dorëzuar duhet të jetë detyrimisht i firmosur dhe i vulosur nga autorët përkatës.

4. Nëse aplikuesi nuk merr përsipër vlerën dysheme të bashkëfinancimit të përcaktuar sipas shtojcës I, të këtij urdhëri, atëherë aplikimi nuk kalon në fazën e vlerësimit.